

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-170/13

**Prishtinë,
23 prill 2013**

Në çështjen juridike të:

M.V

Pala ankuese

kundër.

N.H

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Dag Brathole, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/183/2012 të datës 14 dhjetor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA21714), pas shqyrtimit të mbajtur më 23 prill 2014, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. **Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.V.**
2. **Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/183/2012 i datës 14 dhjetor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA21714).**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 24 shtator 2007, M.V ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (KPA), duke kërkuar të drejtën pronësore/ shfrytëzimit të një banesës prej 72 m2 në katin e dytë të rrugës “Casa Dušana” BB, banesa nr. 6 në Viti.
2. Në kërkesën e tij ai thekson se prona private ishte humbur më 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë.
3. N.H ishte përgjigjur në kërkesë më 13 shkurt 2008 dhe 17 qershor 2008. Ai ka pretenduar të jetë pronari i banesës.
4. Para se të ndodhte kjo, si M.V ashtu edhe N.H kishin paraqitur kërkesa lidhur me banesën para Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore të Kosovës (KKPB). Në Vendimin HPCC/D/236/2005/A&C të datës 16 dhjetor 2005. Me këtë vendim N.H i ishte dhënë e drejta pronësore mbi pronën nëse ai do të paguante një shumë për banesën e cila do duhej të përcaktohej nga Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB). Me të njëjtin vendim ishte vendosur që M.V kishte të drejtë për kompensim nga Drejtorati. Nëse N.H nuk do e paguante shumën e caktuar në DÇPB, M.V do i jepej posedimi mbi pronën në fjalë. M.V kishte kërkuar rishqyrtim të vendimit por kërkesa për rishqyrtim ishte refuzuar nga KKPB-ja me Vendimin Grupor nr. HPCC/REC/76/2006 të datës 18 tetor 2006.
5. Më 14 dhjetor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në Vendimin Grupor KPCC/D/R/183/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA21714) e ka

hedhur poshtë kërkesën. KKKPK-ja theksoi se kërkesa ishte jashtë juridiksionit të vet sepse kontesti tashmë ishte vendosur *res judicata* nga KKPB-ja.

6. Vendimi i është dorëzuar M.V më 13 maj 2013. Ai ka paraqitur ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës më 4 qershor 2013. Ankesa i është dorëzuar N.H më 9 tetor 2013. Ai nuk është përgjigjur në ankesë brenda afatit të paraparë. Gjykata Supreme ka pranuar lëndën më 26 shkurt 2014.

Pretendimet e palëve

7. M.V pretendon se vendimi i KKKPK-së bazohet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe mbi zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
8. KKKPK-ja gabimisht ka konstatuar se kërkesa është shqyrtuar me një vendim të plotfuqishëm dhe rrjedhimisht ajo është dashur të hidhej poshtë në përputhje me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Patundshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (*në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079*). Duke iu referuar nenit 2.6 dhe 31 të këtij ligji, M.V e konteston se kërkesa është në fakt kuadër të mandatit.
9. Për sa i takon meritave, M.V thekson se ai është poseduesi i ligjshëm dhe pronar i banesës së kontestuar në përputhje me dokumentet që ai ka dorëzuar në KKKPK, përfshirë aktvendimin e Gjykatës Komunale në Viti për lëndën P. 197/95, vendimin e Gjykatës Komunale në Viti për lëndën 109/96 dhe kontratën e datës 28 mars 1996 mbi shfrytëzimin e banesës.
10. Sipas M.V, N.H i është dhënë e drejta për të blerë një banesë tjetër në ndërtesën e njëjtë, nr. 5. Kjo rezulton nga vendimi i Gjykatës Komunale në Viti i datës 27 tetor 1994. Gjithë dokumentet që N.H ka dorëzuar, ku kërkon pronësinë e tij mbi banesën nr. 6, janë lëshuar pas vitit 1999.
11. N.H ia ka ofruar M.V22 000 marka gjermane për banesën nr. 6 në fillim të qershorit 1999.

12. M.V thekson se ai është pronari i ligjshëm i banesës nr. 6. Ai e ka humbur pronësinë e tij për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999 dhe përmes diskriminimit. Ai thekson se humbja e pronësisë dhe e posedimit nga ana e tij është shkelje e Konventës Evropiane mbi të Drejtat dje Liritë e Njeriut (KEDLNJ), neneve 8 dhe 14 dhe shkelje e nenit 1 e protokollit 1 të Konventës. Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës këto dispozita janë direkt të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe kanë përparësi në krahasim me dispozitat e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
13. N.H nuk është përgjigjur në ankesë.
14. Para KKKP-së N.H ka theksuar se ai ka jetuar me familjen e tij në banesën nr. 6 që nga viti 1980. Më 29 mars 1996 ai është dëbuar me forcë nga banesa. Sipas Ligjit për Banimin të RS të Serbisë neni 35, 37 dhe 38 ai është diskriminuar pasi që ishte shqiptar etnik.
15. N.H thekson se lënda është vendosur nga Gjykata Komunale e Vitisë (Vendimi 379/94 i datës 27 tetor 1998, Vendimi C.nr. 10/2004 i datës 19 maj 2004, Vendimi i KKPB nr. HPCC/D/236/2005/A&C i datës 16 dhjetor 2005 si dhe Vendimi i KKPB-së nr. HPCC/REC/76/2006 i datës 18 tetor 2006.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

16. Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079).

Juridiksioni

17. Gjykata Supreme vëren se KKPB ka vendosur për të njëjtën lëndë me të njëjtat palë duke lëshuar dy vendime: Vendimin e KKPB-së nr. HPCC/D/236/2005/A&C të datës 16 dhjetor 2005 dhe Vendimin e KKPB-së nr. HPCC/REC/76/2006 të datës 18 tetor 2006. Vendimi i fundit është i plotfuqishëm.

18. Në përputhje me nenin 11.4 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja hedh poshtë kërkesën pasi që “kërkesa është shqyrtuar më herët dhe për të është vendosur me një vendim të plotfuqishëm administrativ ose gjyqësor.”
19. Rrjedhimisht, KKPK-ja ka konstatuar në mënyrë të drejtë se lënda është vendosur më parë me një vendim të plotfuqishëm administrativ ose gjyqësor, në këtë rast vendim të plotfuqishëm administrativ të lëshuar nga KKPB-ja.
20. M.V ka pretenduar se kërkesa është brenda kompetencave të KKPK-së në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Megjithatë, kjo kompetencë nuk mund të ushtrohet nga KKPK-së marrë parasysh se lënda tashmë është shqyrtuar dhe është vendosur përmes një vendimi të plotfuqishëm administrativ. Neni 11.4 (c) i Ligjit nr. 03/L-079 kufizon kompetencën e KKPK-së në këtë aspekt.
21. Pasi që lënda është shqyrtuar dhe vendosur nga KKPB-ja, i cili ishte organi kompetent për të shqyrtuar lëndën në atë kohë, Gjykata Supreme konsideron se hedhja poshtë e kërkesës nga KKPK nuk cenon të drejtat e M.V sipas (KEDLNJ) neni 8 dhe 14, ose neni 1 i protokollit 1 të Konventës.
22. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 pika (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi..

Këshillë Juridike

23. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Dag Brathole, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva - Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it